

=====

International transportation of goods according to the convention on the contract for international carriage of goods by road (CMR)

Diamanta Sojeva

Universiteti i Prishtinës - Fakulteti Ekonomik
diamanta.sojeva@uni-pr.edu

Abstract

Participation, effectiveness and efficiency of road transportation in economic and social processes, depends on the development of road infrastructure, the organization of transport of goods, passengers and traffic and from the long-term policies of the state. The international transportation within the international trade is regulated with conventions, customs and many other international regulations, since the state have ratified and is involved on an equal footing in international exchanges. In most European countries and wider the international road transport of goods is regulated by the Convention on the Contract for International Carriage of goods by Road-CMR. This international legal act regulates the legal – ownership relations with contracts on transporting goods by driver as a person and contractual relation on the side of who send the goods, respectively the receiver of the good. The conventions are applied for every contract for the transportation of goods by road charged in the case when the receiving and arriving country are different and are signatories of the conventions.

Key words: convention, road transport, goods, international

Transporti ndërkombëtar i mallrave sipas konventës mbi kontratën ndërkombëtare për transportin rrugor të mallit (CMR)

Abstrakti

Pjesëmarrja, efikasiteti dhe cilësia e transportit rrugor, në proceset ekonomike-shoqërore, varen nga zhvillimi i infrastrukturës rrugore, organizimi i

transportit të mallit dhe të udhëtarëve dhe nga politika afatgjate e komunikacionit në shtet. Transporti ndërkombëtar në kuadër të tregtinë e ndërkombëtare rregullohet me konventa, zakone dhe rregulla të shumta ndërkombëtare, pasi që shteti t'i ketë ratifikuar dhe të jetë kyçur ashtu në mënyrë të barabartë në këmbimin ndërkombëtar. Në pjesën më të madhe të vendeve evropiane dhe me gjerë transporti ndërkombëtar rrugor i mallrave rregullohet me Konventën mbi kontratën për transportin ndërkombëtar rrugor–CMR.²² Ky akt juridik ndërkombëtar rregullon marrëdhëniet juridike – pronësore nga kontrata mbi transportin rrugor të mallit ndërmjet vozitësit rrugor si person nga marrëdhënia kontraktuese në anën e mjetit të transportit, dhe dërguesit, gjegjësisht marrësit në anën e mallit. Konventat aplikohen për secilën kontratë për transportin rrugor të mallit me pagesë në rastin kur vendi i marrjes dhe vendi i arritjes gjenden në dy shtete të ndryshme, nënshkruese të konventës.

Fjalët kyçe: Konventë, transport, rrugorë, mallra, ndërkombëtar

Hyrja

Transporti rrugor në qarkullimin ndërkombëtar është transporti i mallit dhe i udhëtarëve me automjete rrugore (kamionë, kamionë-frigoriferë, mauna, autobusë etj.) të cilat kryejnë ndërmarrjet për transportin ndërkombëtar të mallit dhe udhëtarëve në pajtim me dispozitat ndërkombëtare mbi transportin rrugor. Sipas Krasniqi A. (2015) transporti i ngarkesave në qarkullimin rrugor mund të kryhet me automjete dhe me rimork. Automjetet lëvizin me ndihmën e motorit të vet kurse rimorkët nuk kanë motor të vet por lidhën për automjete.

Transporti rrugor është forma më fleksibël e transportit, pasi mallrat arrijnë në destinacion me të njëjtin mjet, dhe me të njëjtin format që janë ngarkuar. Përgjithësisht është versioni më tërheqës me përjashtim të rasteve kur distanca gjeografike është tepër e madhe, apo kur aksesit i rrugëve kufizohet nga faktorë gjeografikë. Opsione të tjera transporti përfshijnë transportin hekurudhor, që kufizohet në varësi të rrjetit hekurudhor, dhe për pasojë mund të kryhet nëpërmjet një rruge jo të drejtpërdrejt. Shërbimet postare mund të jenë një opsion për dërgimin e mostrave. Në shumicën e rasteve elementët gjeografikë, prania e shërbimit, si dhe karakteristikat fizike të produktit përbëjnë faktorët kryesorë që influencojnë në vendim-marrje për tipin e transportit. Transporti i mallrave në kuadër të biznesit ndërkombëtar i nënshtrohet një sistemi të posaçëm të kontrollit të mallit dhe shërbimeve në këmbimin e jashtëm dhe lidhur me të bëhet statistikë e

²² Angl. *International Carriage of Goods by Road*; fran. *International Contranct de Transport de Marchandises par Route* –

=====

posaçme, e cila i jep të dhënat mbi përcjelljen dhe krahasimin e këmbimit të mallit dhe të shërbimeve të shtetit me jashtë (sipas grupeve të mallit, shërbimeve ekonomike, vlerave, sasive, shteteve të eksportit dhe importit etj.

Ky aktivitet duhet që të përcjellët dokumentacion të posaçëm, mënyrë e posaçme e llogaritjes së çmimit me metoda të ndryshme të kalkulimeve në tregtinë e jashtme, shpenzime të posaçme (p.sh taksat doganore dhe të tjera, taksat e posaçme etj) si dhe procedura të veçanta. Po sipas Krasniqi Armand (2015) konventa mbi marrëveshjen ndërkombëtare të transportit rrugorë të mallit (CMR), është ndër instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare që i përcakton dhe lehtëson llojet dhe efekti e transportit të mallrave në sferën ndërkombëtare duke të bërë një përkufizim të rolit dhe rëndesës se marrëdhënieve kontraktore ne përcaktimin e obligimeve dhe përgjegjësiive te subjekteve te cilat janë te involvuara gjate transportit rrugore te mallrave si dhe mënyra e përdorimit te kësaj konvente duke përfshirë dhe te dhënat qe duhet te i përmbaj lista e mallrave sipas konventës CMR.

Konventa për marrëveshjen ndërkombëtare të transportit rrugor të mallit (CMR)

Zhvillimi i transportit rrugorë ndërkombëtarë posaçërisht pas Luftës së Dytë Botërore, ka shfaqë nevojën për akte ligjore apo nevojën për harmonizimin e rregullave të cilat kanë qenë të ndryshme në shumë vende të ndryshme. Për këtë arsye janë nënshkruar Konventat për transportin rrugorë me 19 shtator 1949, e cila më vonë është reviduar me 8 nëntor 1968 në Gjenevë dhe konventa mbi marrëveshjen e transportit ndërkombëtarë rrugorë të mallit (Convention on the Contrakt for the International Carriage of Goods by Roads). "Konventa CMR daton prej 19. Majit dhe ka hyre ne fuqi me 2 Korrik 1961." (Faruk Jasharoviç dhe të tjerë)

Me konventën CMR është rregulluar mënyra e përdorimit të saj, përgjegjësitë e transportuesit për veprimet ose lëshimet e tij, veprimet dhe lëshimet e përfaqësuesve dhe personave përgjegjës të tyre, si dhe autorizuesve të tyre. Sipas Konventës CMR marrëveshja për transportin ndërkombëtar të mallit arrihet me rastin e prezantimit të listës së mallit për ngarkim, i cili shërben si dëshmi e marrëveshjes së arritur mbi transportin e mallit, kushtet e marrëveshjes dhe pranimin e mallit nga ana e transportuesit.

Përgjegjësitë dhe te drejtat e dërguesit te mallit

Dërguesi i mallit ka të drejt në posedimin e mallit. Gjithashti ka të drejt të kërkojë që transportuesi gjatë transportit ta ndalë mallin në rrugë, ta ndërrojë vendin e destinacionit ose mallin t'ia dërgojë ndonjë pranuesit tjetër të mallit,

ndryshe nga pranuesi i mallit i cili është shënuar në listën e mallit. Kjo e drejtë ndërpritet me rastin e dorëzimit të mallit, ose të ekzemplarit të dytë të listës së mallit, pranuesit të shënuar në listë. Sipas Faruk Jasharović, Velibor Peulić dhe Davorin Pehar “Dërguesi i mallit është përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet apo dëmtimet të cilat që ja ka shkaktuar transportuesit si rezultat i mos mbushjes së sakte të listës ngarkuese, në lidhje me informatat të cilat dërguesi duhet të i siguroj.”

Përgjegjësit dhe të drejtat e transportuesit të mallit

Sipas autorëve të lartpërmendur Përgjegjësia kryesore e transportuesit është që të dorëzojë mallin në të njëjtën gjendje në të cilat dhe i ka pranuar. Transportuesi përgjigjet për mallin e pranuar dëmtimin ose humbjen e pjesshme apo të plotë të mallit, nga momenti kur e ka pranuar mallin deri në momentin e dorëzimit të tij si dhe vonesat në dorëzim. Me vonesa në dorëzim nënkuptohet nëse malli nuk është dorëzuar në afatin e caktuar kohor, ose nëse, në mungesë të afatit të caktuar kohor, kohëzgjatja reale e transportit pa marrë parasysh rrethanat ekzistuese tejkalon kohën e cila mund të jetë e pranueshme për një vozitës të rregullt.

Kompensimi për vonesa në dërgesë nuk do të paguhet nëse vozitësit nuk i është dhënë vërejtja me shkrim në afat prej 21 ditëve duke llogaritur edhe ditën kur malli i është dorëzuar pranuesit.

Afati i vjetërsimit për ngritje të padisë, lidhur me transportin, sipas kësaj konvente është 1 vit, përjashtim në rastet qëllimkëqija ose lëshimeve të cilat sipas vlerësimit të gjykatës kompetente konsiderohen si qëllimkëqija, kur afati i vjetërsimit të mbush tre vjet.

Kur, sipas akteve të kësaj konvente, vozitësi përgjigjet për kompensimin e dëmit për arsye të dëmtimit apo humbjes të plotë ose të pjesshme të mallit, kompensimi llogaritet sipas vlerës të cilën malli e ka pasur në momentin e dorëzimit për transport. Vlera e mallit do të përcaktohet sipas çmimit të mallit në berzë, ose nëse një çmim i tillë nuk ekziston atëherë përcaktimi i çmimit bëhet sipas çmimit të tregut, ose nëse edhe ky çmim nuk ekziston atëherë çmimi përcaktohet sipas çmimit të ndonjë malli të llojit dhe kualitetit të njëjtë.

Në rast të humbjes të tërësishme të mallit përpos kompensimit të humbjes kompensohen edhe harxhimet e transportit, doganës dhe harxhimet tjera lidhur me transportin e mallit, ndërsa të humbja e pjesshme kompensimi është proporcional.

Dërguesi mundet, nëse paguan çmim të shtuar transporti, në listën e mallit ta shënoj vlerën e shtuar të mallit e cila tejkalon kufizimet sipas kësaj konvente, dhe me këtë, në rast të humbjes së mallit transportuesi është i obliguar ta kompensojë këtë vlerë.

=====

Teksti origjinal i Konventës CMR gjendet nën kujdes të Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Lista e mallit për transportin ndërkombëtar rrugor (CMR)

Faruk Jasharović, Velibor Peuliq dhe Davorin Pehar deklarojnë se lista e mallit për transportin ndërkombëtarë rrugorë “jepet në tri ekzemplar origjinale, të cilat nënshkruhen nga ana e dërguesit dhe transportuesit, parimisht, kopja e katërt jepet për transportuesin. Nënshkrimet mund të jenë shtypura në faksimile ose manë të vulave të dërguesit dhe transportuesit nëse një gjë të tillë e lejon ligji i atij vendi në të cilën lista e mallit është lëshuar. Ekzemplari i parë me ngjyre të kuqe i mbetet dërguesit, ekzemplari i dytë i kaltër shkon se bashku me mallin tek marrësi pasi që malli arrin në destinacion ndërsa kopja e tretë e gjelbër dhe e katërta i mban transportuesi.

Sipas po të njëjtëve autorë, kopja e dytë e tretë dhe e katërt duhet të jenë se bashku me mjetin transportues dhe mbesin në mjetin transportues gjithë kohën deri sa malli të jetë i ngarkuar në mjetin transportues”

Nëse malli që transportohet duhet të ngarkohet në automjete të ndryshme ose malli është i llojeve të ndryshme apo është e ndarë në grupe të ndryshme, dërguesi ose transportuesi kanë të drejtë të kërkojnë që për çdo automjet të përdorur ose për çdo lloj ose sasi të mallit të lëshohet listë e veçantë e mallit.

Lista e mallit duhet të përmbajë të dhënat si në vijim:

- data dhe vendi i dorëzimit të listës së mallit;
- emri dhe adresa e dërguesit;
- emri dhe adresa e transportuesit;
- vendi dhe data e ngarkimit të mallit dhe vendi i destinacionit;
- vendi dhe adresa e pranuesit;
- përshkrimi i zakonshëm i llojit të mallit dhe mënyra e ambalazhimit, ndërsa për materiale të rrezikshme emërtimi i përgjithshëm i pranuar;
- numri i kolektave, shenjat e tyre të veçanta dhe numrat;
- pesha bruto e mallit ose sasia e shprehur në formë tjetër;
- harxhimet e transportit (transporti, harxhimet shtesë, dogana dhe harxhimet tjera të cilat janë shkaktuar nga momenti i marrëveshjes deri te dërgimi i mallit);
- udhëzimet e nevojshme për formalitetet doganore dhe të tjera;
- deklarata mbi atë se transporti i malli i nënshtrohet Konventës CMR, pavarësisht nga ndonjë rregullore kundërtënëse;

=====

Kur kjo të jetë e mundur, lista e mallit, duhet të përmbaj edhe të dhëna tjera:

- ndalimin e zbarkimit dhe ngarkimit përgjatë rrugës;
- harxhimet të cilat i bartë dërguesi;
- shuma e cila duhet të paguhet në momentin e dorëzimit të mallit;
- shenja përcaktuese të vlerës së mallit dhe shuma e cila paraqet një rëndësi të veçantë të dërgesës;
- udhëzimet e dërguesit për transportuesin, në kuptim të sigurimit të mallit;
- afati kohorë në të cilin duhet të kryhet transporti;
- lista me dokumentet të cilat iu janë dhënë transportuesit;

Palët e marrëveshjes, në listën e mallit, mund të fusin edhe detaje tjera të cilat i konsiderojnë të rëndësishme të dhënat e shënuara nën pikën 1; nën c), d), e), f), g), h), dhe j); të dhënat e shënuara nën pikën 2; cilado e dhënë tjetër ose udhëzim të cilat dërguesi i jep me qëllim që të mundësohet dhënia e listës së mallit ose që të mundësohet futja e të dhënave në të.

Nëse me kërkesë të dërguesit, transportuesi në listën e mallit i fut të dhënat e përmendura nën a), b) dhe c), do të konsiderohet, nëse nuk argumentohet e kundërta, se këtë e ka bërë në emër të dërguesit.

Nëse lista e mallit nuk përmban deklaratën të shënuar në pikën 1; nën k), transportuesi do të përgjigjet për të gjitha harxhimet dhe dëmet të cilat janë shkaktuar, ndaj atij që posedon të drejtën mbi mallin, për arsye të këtij gabimi.

Në momentin e marrjes së mallit transportuesi është i obliguar të vërtetoj: saktësinë e përmbajtjes në listën e mallit lidhur me numrin e koleteve, shenjat e tyre dhe numrat, dhe gjendjen në pamje të jashtme të mallit dhe të ambalazhit të saj.

Nëse lista e mallit nuk përmban ndonjë vërejtje të veçantë të transportuesit, konsiderohet, nëse nuk argumentohet e kundërta, se malli dhe ambalazhi i saj kanë qenë në gjendje të rregullt në momentin kur transportuesi e ka pranuar mallin dhe që numri i koleteve, shenjat e tyre dhe numrat kanë qenë në përputhshmëri me shënimet e listës së mallit.

Për nevojat e doganës dhe formaliteteve tjera të cilat duhet të kryhen para dërgesës së mallit dërguesi duhet që bashkë me listën e mallit të bashkëngjit dokumentacionin e nevojshëm ose t'ia jap transportuesit në dispozicion, dhe ti ofroj atij të gjitha të dhënat të cilat i kërkon. Transportuesi nuk është i obliguar të vërtetojë saktësinë ose rregullsinë e këtyre dokumenteve. Dërguesi i jep llogari transportuesit

=====

për çfarëdo dëmi të shkaktuar për shkak të mungesës, parregullsisë ose pasaktësisë të dokumenteve apo të dhënave të tilla, përpos në rast se transportuesi ka vepruar nga pakujdesia dhe neglizhenca.

Me të arritur malli në vendin e dërgesës pranuesi mund të kërkojë me vërtetim nga transportuesi t'ia jap atij ekzemplar të dytë të origjinalit të listës së mallit. Nëse konstatohet humbje e mallit, ose nëse malli nuk arrin, pas skadimit të afatit të paraparë kohorë të dërgesës, pranuesi mund ta shfrytëzojë të drejtën nga marrëveshja mbi transportin e mallit në emër të vet.

Nëse paraqiten pengesa tek dërgesa e mallit pas arritjes së tij në vendin e destinacionit, transportuesi duhet të kërkojë udhëzime nga dërguesi. Nëse pranuesi e refuzon pranimin e mallit, dërguesi ka të drejtë të posedoj mallin pa dorëzimin e ekzemplarit të parë të origjinalit të listës së mallit.

Transportuesi ka të drejtë të kërkojë kompensimin e harxhimeve të cilat janë shkaktuar gjatë kërkimit të udhëzimeve nga dërguesi, si dhe harxhimet e shkaktuara për realizimin e atyre udhëzimeve, përpos nëse ato harxhime janë shkaktuar me faj të transportuesit.

Përfundimi

Dekadat e fundit mjetet e transportit rrugor janë shtuar dukshëm. Ky ekspansion bazohet në ndërtimin e rrjetit rrugorë bashkëkohorë, zgjidhjet racionale dhe teknologjinë moderne të punës gjatë transportit.

Ndërtimi shumë intensiv i rrugëve moderne, autostradave të gjëra dhe mbi objekteve për bartjen e peshave të mëdha (uratë, viaduktet, etj), mundësojnë transportin rrugorë të gjitha peshave jo të zakonshme për nga masa dhe dimensionet, dhe të cilat nuk mund të transportohen me llojet tjera të transportit.

Transportin ndërkombëtar i mallrave patjetër duhet të përputhet me konventat ndërkombëtare për zhvillimin e llojit të transportit. Me ato konventa, si dhe me marrëveshjet bilaterale midis vendeve, rregullohen marrëdhëniet e vendeve në fushën e transportit. Ato janë dedikuar për marrjen e lejeve ndërkombëtare, për shumën e doganës, kushtet e transportit, të importit, transitin dhe specifika të tjera.

Transporti rrugorë mundëson transport të drejtpërdrejt "prej shtëpisë në shtëpi" pa ngarkim të mallit përgjatë rrugës që ndikon negativisht në kualitetin e mallit, dhe në këtë mënyrë gjithnjë më shumë i konkurren transportit hekurudhorë. Asnjë masë e kufizimit të kushtëzuar të transportit rrugorë ndaj atij hekurudhorë nuk mund të japin rezultate. Tash për tash, e vetmja zgjidhje është modernizimi (transporti integral dhe të ngjashme) në mënyrë që transporti hekurudhor, deri diku, të mund të garoj në konkurrencë me transportin rrugorë, në aspektin e kualitetit,

=====

realizmit në praktik të transportit dhe çmimeve të tyre.

Në transportin rrugorë të mallrave sipas konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare mbi transportin e mallit transportuesi obligohet që mallin e pranuar për transport ta transportojë në vendin e destinimit dhe aty në atë vend t'ia dorëzojë pranuesit të mallit apo personit tjetër të autorizuar i caktuar nga pranuesi, ndërsa dërguesi i mallit obligohet që transportuesit ti paguaj në emër të transportit shumën e akorduar. Në komunikacionin rrugorë si dokument transporti është lista e mallit, e cila njëkohësisht shërben si argument se është bërë marrëveshja mbi transportin e mallit.

Dërguesi i mallrave gjatë transportit rrugor është i obliguar që të i përgatis ato sipas specifikave të mallrave të i paketojë dhe të etiketojë varësisht prej llojit të mallit, po ashtu është i obliguar që të tërë dokumentacionin të ja dërgoj transportuesit të mallrave me të gjitha të dhënat e nevojshme për cilësi dhe kualitetin e mallrave.

Konventa mbi kontratën për transportin ndërkombëtar rrugor-angl. International Carriage of Goods by Road; fran. International Contranct de Transport de Marchandises par Route - **CMR** rregullon marrëdhëniet juridike-pronësore nga kontrata mbi transportin rrugor të mallit ndërmjet vozitësit rrugor si person nga marrëdhënia kontraktuese në anën e mjetit të transportit, dhe dërguesit, gjegjësisht marrësit në anën e mallit. Konventat aplikohen për secilën kontratë për transportin rrugor të mallit me pagesë në rastin kur vendi i marrjes dhe vendi i arritjes gjenden në dy shtete të ndryshme, nënshkruese të konventës.

Literatura

- Krasniqi A., E drejta biznesore ndërkombëtare , 2015 fq.217, 233
- Convention on the Contract for the International Carriage of Goods by Road (CMR) - (Geneva, 19 May 1956) United Nations (UN)
- Faruk Jasharović; Velibor Peulić; davorin Pehar. Vodič za Vozača U međunarodnom Cestovnom Transportu
- <http://www.jus.uio.no/lm/un.cmr.road.carriage.contract.convention.1956/doc.html>